

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E HËNË 3 TETOR 2022

Do t'i përgjigjem vetëm me një fjalë ministres së Arsimit. Pa diskutim që ne na shqetëson shkelja e ligjit në raport me mbylljen e shkollave në këtë vend dhe çdo influencë apo ndërhyrje që mund të jetë përtej ligjit. E kam lexuar raportin, ndaj ju thashë të lexonit raportin, që ta dëgjonin edhe qytetarët se ku është shkelur ligji. Më ka bërë përshtypje që ju kishit gjetur se nuk kishte tualet djemsh në një shkollë që është kolegji vajzash dhe për këtë arsye shkolla duhej mbyllur. Këtu kuptohet se sa serioze është mbyllja e shkollës dhe me kaq po e lë, sepse kishte edhe kërkesa të tjera, që në kopsht kërkonit të kishte lartësi të mëdha. Raportin e lexova. Dukej serioziteti i kësaj çështjeje në raport me ligjin, si në çdo çështje tjetër.

Ato që tha Kryeministri, për fat të keq, edhe një herë tjetër, nuk dua të them ndonjë fjalë nga ato që përdor ai: "...ishin mashtrime të rënda", por ishin të pavërteta të mëdha, sepse sot, për aq sa lejohet të thuhet pas një mbledhjeje me dyer të mbyllura, një institucion, që, pa diskutim, është më i mirëbesueshëm dhe më prestigjioz për shkak se ka një mbikëqyrje më të fortë nga partnerët strategjikë që i përdorni vend e pa vend, konfirmoi që ka rrjedhje të të dhënave sensitive. Nuk po hyj në detaje t'ju them cilat janë, por ka rrjedhje të të dhënave sensitive në këtë vend, ka prekje të sistemeve që nuk duheshin prekur, sidomos në Policinë e Shtetit dhe në sistemet e mbyllura të Policisë së Shtetit.

Qeveria ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë. Nëse ka dikush mundësi të përgjigjet, sepse Kryeministri iku, mund të na thoni se sa shpenzon Shqipëria sot, sa shpenzonte edhe dje, nëse doni, për mbrojtjen kibernetike? A ka ndonjë shpenzim për mbrojtjen, apo jo? A ka ndonjë përgjegjës deri më sot? Cilët janë përgjegjësit? Këto ndodhin në mënyrë të përsëritur dhe përpiqen të mbulohen nëpërmjet propagandës. Disa patronazhistë, nga këta që nxorrën të dhënat, shkuan për ndjekje penale, por të gjithëve iu mbyllën hetimet, janë jashtë. Ndaj kur flasim për hetimet dhe për sistemin e drejtësisë, jemi të shqetësuar dhe themi se kontrollohet nga Kryeministri.

Një çështje tjetër që u hap këtu, sepse po e përmbledh për shkak të kohës, ishte çështja ruse. Po, ne i besojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe mbajmë të njëjtin qëndrim në çdo rast. Po, kjo është një çështje shqetësuese. Kryeministri nuk thotë dot: “Ku hyj unë këtu? Po, si Kryeministër i Republikës së Shqipërisë kanë dështuar institucionet”. Nëse kanë penetruar para ruse në këtë vend, të mos dilte të bënte propagandë dhe politikë e t’i jepte mbrojtje politike kujtdo, por të bënte mbledhje dhe diskutim real në parlament, të adresonim, siç themi edhe sot: hajdeni të adresojmë. Cili është propozimi juaj? Të bëjmë një projektligj, një ligj që ta ashpërojmë, por kjo nuk mundet të përdoret sa herë që duhet për interesa të vogla politike. Kush ka marrë nga kjo? Thotë një fjalë ai, që nuk po e them, por le të kërkojë ndonjë qindarkë në xhepat e dikujt këtu, para ruse ose jo ruse.

Nëse i intereson të përdorë politikisht dikë për interesa të veta politike, kjo nuk është aspak çështje serioze. Ne duhet ta adresojmë. Ja ku jemi: silleni ta diskutojmë! Mund t’jua propozojmë ne. Edhe ne mund të na duhet të kemi një propozim konkret për të. Sot, shqetësimi kryesor që kanë zgjedhësit në qarkun e Korçës, që sa herë shkoj për t’i takuar, ata që më kanë votuar ose jo, i gjej përherë e më pak, përherë e më në dëshpërim, përherë e më të varfër, është ngrohja. Ata nuk do të kenë ngrohje për shkak të energjisë që ju do ta rrisni muajin tjetër dhe nuk do të kenë ngrohje as me dru, siç ka qenë tradicionalisht, sepse çmimi i një meter dru ka shkuar 75 mijë lekë. Ndërkohë, një projekt tjetër që nuk e çoni dot në fund është projekti Qukës-Qafë-Plloç, që ka ngelur i zvarritur prej vitit 2013.

Meqenëse jemi te rrugët, një denoncim tjetër që kam bërë po këtu, po ashtu edhe personalisht, është për rrugën Kardhiq-Delvinë. Dyfishim i kostove. Sot ishte në prokurori ish-drejtuësja e ARSH-së. Ne inkurajojmë prokurorinë, pavarësisht se pas 2 vjetëve ka nisur të thërrasë, t’i shkojë hetimit deri në fund. Ne i inkurajojmë sot dhe nuk duhet ta mbulojë askush faktin që aty ka një kallëzim penal po për atë drejtuese ndaj kompanisë së “Rrugës së Arbrit”, që kishte marrë më shumë se 50 milionë euro, sipas denoncimit, dhe kishte punë të pakryera.

Këta janë të njëjtët oligarkë që bëjnë edhe ndërtimet, edhe pallatet në Tiranë, që nuk iu shkon Policia e Shtetit, që nuk iu shkon IKMT-ja, që Kryeministri është i pafuqishëm, janë të pafuqishëm ministrat dhe është e pafuqishme e gjithë qeveria, që edhe sot e kësaj dite,

pavarësisht se ka 1 muaj, nuk më kanë kthyer dot përgjigje se cilat subjekte kanë ndërtuar pa leje, pse nuk i kanë referuar në prokurori dhe cilët prej inspektorëve janë referuar në prokurori, ata të cilët kishin për detyrë të zbatonin ligjin?

Siç e ka thënë edhe vetë Kryeministri më parë dhe duhet ta rikujtoj, sepse tha pak më parë: nuk mbani përgjegjësi për ato që thoni, por vetëm disa muaj më parë, ai ka thënë se drejtuesit e pushtetit vendor janë përgjegjës dhe do t'u bëjmë kallëzim penalisht për çdo ndërtim të paligjshëm. Po sot pse nuk flet Kryeministri? Po policët pse nuk shkojnë të rrethojnë gradaçelat në mes të Tiranës? Po Inspektorati Ndërtimor pse nuk çon fadromat t'i prishë? Ia kanë lidhur duart. Me çfarë ia kanë lidhur duart Kryeministrit?